

Vazhdon mbështetja e shtetit austriak për arsimin e lartë në Kosovë

Austria ndihmon UP-në me pesë projekte në tre vjetët e ardhshëm

Gjatë tre vjetëve shteti austriak do të ndihmojë arsimin e lartë publik kosovar në zhvillimin e tri programeve master, në zhvillimin e kurrikulit, prurjen e profesorëve të huaj, do të mbështesë Njësinë e zhvillimit akademik të UP-së, si dhe do të mundësojë që studentët kosovarë të sfidojnë njohuritë e tyre në garën ndërkombëtare "Rasti sfidues i Ballkanit"

REPORTAZHI

BESNIK KRASNIQI

PRISHTINË, 5 SHITATOR – Me pesë projekte, që kanë për qëllim mbështetjen për procesin reformues, Agjencia Austriake e Zhvillimit do ta mbështetë Universitetin e Prishtinës në tre vjetët e ardhshëm. Të pesë projektet, për implementimin e të cilave shteti austriak ka ndarë 833 mijë euro, janë lansuar të premten dhe janë mirëpritur nga menaxhmenti i Universitetit publik dhe përfaqësuesit e fakulteteve të këtij universiteti. Sipas asaj që u prezantua nga implementuesi i projekteve, WUS Austria, gjatë tri viteve shteti austriak do ta ndihmojë arsimin e lartë publik kosovar në zhvillimin e tri programeve master, në zhvillimin e kurrikulit, prurjen e profesorëve të huaj, do të mbështesë Njësinë e zhvillimit akademik të UP-së, si dhe do të mundësojë që studentët kosovarë të sfidojnë njohuritë e tyre në garën ndërkombëtare "Rasti sfidues i Ballkanit".


Udhëheqësi i Zyrës austriake për zhvillim, Andreas Fritz, ka theksuar se programi synon të sfidojë profesorët dhe studentët e UP-së me qasjet e avancuara në sistemin arsimor dhe në veçanti ballafaqimin me metodat e reja të mësimin.

Austria është financuesi më i madh i projekteve në arsimin kosovar, dhe sipas Fritzit një nga arsyeve më kryesore pse është zgjedhur Kosova për investime në arsim është fakti se projektet këtu janë implementuar me shumë sukses.

But Dedaj, koordinator i programeve të WUS-it për Kosovë, tekta ka shpjeguar formën e implementimit të projekteve, është shprehur se programet master janë krejtësisht të reja dhe të orientuara nga tregu i punës, dhe ka bërë të ditur se Rektorati ka vendosur që ato të implementohen në Fakultetin Juridik, në Fakultetin Filozofik dhe në Fakultetin e Mjekësisë.

Me projektin e dytë, zhvillimi i kurrikulit plus, Dedaj ka thënë se do të mbështeten profesorët që zbatojnë lëndë të reja mësimore, apo aplikojnë metodologji të re shkencore në lëndët ekzistuese. Profesorët do të mbështeten financiarisht për honorarët, për vizita studimore jashtë vendit dhe fakultetet do të kenë mundësi të blerjes së pajisjeve të nevojshme në vlerë deri në 10 mijë euro.

Projekti i tretë, i emëruar "Zhvillimi i trurit", synon të sjellë në Kosovë rreth 50 profesorë të lëmenjve të cak-



tuar për të mbajtur cikle ligjërimesh në UP. Ata do të kenë mundësi të vijë për hulumtime shkencore në Kosovë dhe po ashtu të jenë mentorë, për ta udhëhequr punën e ndonjë kandidati për tituj shkencorë pasuniversitarë.

Me projektin e katërt synohet punësimi i një zyrtari në Rektoratin e UP-së, që do të kujdeset për reformën dhe zhvillimin e kurrikulit. Projekti i pestë është "Rasti sfidues i Kosovës", që do të jetë gjysmëfinale e "Rastit sfidues të Ballkanit", i cili çdo vit organizohet në Austri. Me këtë synohet të nxiten studentët për t'u sfiduar me kolegët e tyre në këtë garë të njohurive. Për koordinatorin e programeve të WUS-it për Kosovë, But Dedaj, gjithë këto projekte do të thonë "mbështetje përmbytëse për procesin reformues", me të cilat synohet që arsimi i lartë kosovar të bëhet pjesë e arsimit të lartë evropian.